



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

VLORE

Nr. Rregj.Themeltar 2209  
Dt rregjistrimi 02.12.2019

Nr. Vendimi 2209  
Dt. Vendimi 02.12.2019

VENDIM  
"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

"Për vendosjen e sekuestros preventive"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e përbërë nga

GJYQTARE - ELONA MIHALI

Sot më datë 02.12.2019, ora 14:45 mori në shqyrtim në Dhomë Këshillimi, kërkesën penale me Nr. 2209 Rregj. Themeltar, që i përket:

Kerkues: Prokuroria pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Vlorë, përfaqësuar nga prokurori [REDACTED] (në mungesë)

Objekti: Kërkohet caktimi i masës së sigurimit pasurore të sekuestros preventive të parashikuar nga numri 274 të K.Pr.Penale, në kuadër të procedimit penal nr. 778 të vitit 2014, mbi pasuritë e mëposhtme:

1. Pasurisë së paluajtshme e llojit njësi shërbimi me sipërfaqe 50.5 m<sup>2</sup>, që ndodhet në ZK 8603, Vlorë, me nr. 26/177-N8, vol 37, faqe 124, e cila ndodhet në lagjen "Lef Sallata", Vlorë, e blerë nga shtetasja [REDACTED] përmes kontratës së shitblerjes nr. 1267 rep dhe nr. 1016 kol, datë 09/09/2010, kundrejt çmimit prej 5.252.000 Lekë.
2. Pasurisë së paluajtshme që ndodhet në ZK 3140, Vlorë, me numër 159/217 vol 10, faqe 73, e llojit pemishte, me sipërfaqe 600 m<sup>2</sup>, e blerë nga shtetasja [REDACTED] përmes kontratës nr. 1526 rep dhe nr. 1039 kol, datë 22/07/2010, në shumën prej 4.200.000 Lekë.
3. Pasurisë së paluajtshme e llojit apartament nr. 8, i përbërë nga 1+1, në katin e pestë nga toka, që ndodhet në objektin e ndërtuar në Orikum, sipas lejes së ndërtimit nr. 7/3, datë 08/12/2008 të KRRT-së pranë Bashkisë Orikum, objekt i cili është ndërtuar nga subjekti " [REDACTED] " sh.p.k, i cili është blerë përmes kontratës së premtim shitje nr. 1364 rep dhe nr. 1200

- kol, datë 11/09/2010, nga shtetasi [REDACTED] në shumë prej 25.000 Euro.
4. Pasursë së paluajtshme e llojit apartament banimi të tipit 36, me sipërfaqe 120.2 m<sup>2</sup>, me dy dhoma gjumi, dy banjo, korridor dhe dy ballkone, i cili ndodhet në katin e tetë nga toka, në objektin " [REDACTED] " të ndërtuar në lagjen "Pavarësia", Vlorë, sipas lejes së ndërtimit nr. 4/52, datë 15/09/2006 të KRRT-së pranë Bashksie Vlorë, objekt i cili është ndërtuar nga subjektet " [REDACTED] " sh.p.k dhe " [REDACTED] " sh.p.k dhe i prenotuar nga shtetasi [REDACTED] përmes kontratës nr. 1762 rep dhe nr. 1243 kol, datë 21/10/2009, për të cilin është paguar shumën prej 42.000 Euro.
  5. Të shumës prej 709,251.27 Lekë, të depozituara në Bankën Kombëtare Tregtare, në llogarinë nr. 408029669TIMDEPALLAV, në emër të shtetasve [REDACTED] e [REDACTED]
  6. Të shumës prej 20,059.55 Euro, të depozituara në Bankën Kombëtare Tregtare në llogarinë me numër 408141852TIMDEPEURAQ, në emër të shtetasve [REDACTED] e [REDACTED]
  7. Të automjetit targa VL 7612 C, i regjistruar në emër të shtetasit [REDACTED], i cili është blerë në shumën prej 3.000 Euro.
  8. Të automjetit me targa [REDACTED], i regjistruar në emër të shtetasit [REDACTED] i cili është blerë në shumën prej 130.000 Lekë.

Baza Ligjore:

Neni 36 i Kodit Penal, si dhe nen 274 i Kodit të Procedurës Penale.

*Gjykata pasi shqyrtoi dhe vlerësoi në tërësi rrethanat e çështjes mbi bazën e provave të paraqitura bashkëlidhur kërkesës, pasi u konsultua me legjislacionin në fuqi,*

#### VËREN SE:

##### I. Rrethanat e faktit.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me kërkesën me objektin dhe bazën ligjore si më sipër identifikuar.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, ka regjistruar procedimin penal nr. 778 datë 13.05.2014, për veprën penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale" të parashikuar nga nen 287 i Kodit Penal.

Ky procedim penal është regjistruar mbi bazën e materialeve referuese të ardhura nga Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë. Më datën 02/12/2019, në regjistrat e njoftimit të veprave penale është shënuar emri i shtetasit [REDACTED], si personi që i atribuohet kryerja e veprës penale të parashikuar nga neni 287/1 të Kodit Penal.

Nga permbytja e materialit të këtij procedimi penal si dhe dokumentacionit bashkangjitur, rezulton se:

Shtetasi [REDACTED] i datëlindjes 31/10/1981 është arrestuar në Itali më datë 25/06/2011 për shkelje të legjislacionit mbi lëndët narkotike. Me vendimin përfundimtar nr. 3547/2012 Gjykata e Apelit të Fierences e ka dënuar me 4 vite e 8 muaj burg dhe me 18.000 Euro gjobë. Nga përbajtja e vendimit rezulton se ky shtetas në bashkëpunim me një shtetas tjetër, ka poseduar në mënyrë të paligjshme lëndë narkotike, e konkretisht dy njësi që përbanin 499,9 gr dhe 536 gr kokainë me princip aktiv në përqindje respektivisht 22.8% dhe 15.3%, që do të thotë të barabarta me 111.977 mg dhe 82.069 mg lëndë e pastër, që korrespondojnë 760 dhe 547 doza të veçanta që kanë efekt drogues dhe 18 pako që përbanin 1.7392 kg kokainë. Hetimet që kanë çuar në arrestimin e shtetasit [REDACTED] kanë nisur në muajin dhjetor të vitit 2010 dhe dyshohet se aktiviteti i paligjshëm është realizuar nga kjo periudhë e deri më datë 25/06/2011.

Shtetasi [REDACTED] është hetuar edhe në kuadër të procedimit penal nr. 1030/2010 mod. 21 R.G.N.R të Prokurorisë së Republikës pranë Gjykatës së Firences. Për këto hetime, të lidhura me shkeljen e legjislacionit mbi lëndët narkotike, ky shtetas është arrestuar më datë 25/03/2014 në Arezzo, në zbatim të urdhërit për masën e sigurisë arrest në burg të dhënë më datë 07/03/2014, nga Gjykatësi për Hetimet Paraprake i Gjykatës së Firences. Më pas pozicioni i shtetasit [REDACTED] është veçuar dhe është regjistruar në procedimin penal nr. 7577/2017 mod. 21 R.G.N.R i Prokurorisë së Firences dhe rezulton ende në fazën e hetimeve paraprake. Arrestimi i shtetasit [REDACTED] më datën 25/03/2014, ka lidhje me të njëjtat hetime të cilat kanë çuar në arrestimin e tij në flagrancë më datë 25/06/2011. Aktiviteti i paligjshëm dyshohet se është kryer nga muaji Dhjetor i vitit 2010 e deri në datën e arrestimit të tij.

Rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, ka regjistruar procedimin penal nr. 1699 datë 26/08/2015, për veprën penale të parashikuar nga neni 283/1 të Kodit Penal në ngarkim të shtetasit [REDACTED]. Nga të dhënat e këtij procedimi penal rezulton se në orën 00:56 të datës 26/08/2015, policia gjyqësore ka arrestuar në flagrancë shtetasin [REDACTED] me një sasi lënde narkotike me peshë të përgjithshme prej 2.8 (dy pike tetë) gram. Ndërsa me vendimin nr.191, datë 12/04/2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është deklaruar fajtor i pandehurit [REDACTED] për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe është dënuar me 5 (pesë) vite burgim, duke aplikuar nenin 59 të Kodit Penal.

Rezulton se edhe shtetasi [REDACTED] alias [REDACTED] alias [REDACTED], i datëlindjes 27/06/1977, i cili është vëllai i shtetasit [REDACTED] është arrestuar më datë 25/03/2014, në zbatim të urdhërit për masën e sigurisë arrest në burg nr. 5212/2012 Reg. Gen të Gjykatësit për Hetimet Paraprake, i dhënë më datë 07/03/2014

nga Gjykatësi i Hetimeve Paraprake të Gjykatës së Firences në kuadër të procedimit penal nr. 1030/2010 R.G.N.R. mod 21. Më pas pozicioni i shtetasit [REDACTED] është veçuar dhe është regjistruar në procedimin penal nr. 7577/2017 mod. 21 R.G.N.R i Prokurorisë së Firences dhe rezulton ende në Tazëri e Heffneve paraprake. Aktiviteti i paligjshëm dyshohet se është kryer nga muaji Dhjetor i vitit 2010 e deri në datën e arrestimit të tij.

Rezulton se shtetasi [REDACTED] nuk është regjistruar nga autoritetet italiane për kryerjen e ndonjë aktiviteti tregtar apo si nëpunës. Ndërsa shtetasi [REDACTED] është zotëruar i firmës " [REDACTED]", në cilësinë e sipërmarrësit të vogël. Ky subjekt tregtar është regjistruar më datë 11/03/2015 me kapital të investuar në shumën 1.000 Euro dhe aktiviteti kryesor është tregimi me pakicë i makinave të vogla. Ndërsa gjatë periudhës nga muaj Dhjetor i vitit 2014 e deri në muajin Shkurt të vitit 2015, ky shtetas ka punuar herë pas here në firmën e ndërtimit " [REDACTED]" dhe ka fituar përafërsisht shumën prej 3.800 Euro.

Nga hetimet e kryera në lidhje me pasuritë e shtetasve [REDACTED] dhe [REDACTED] rezulton se babai i tyre [REDACTED] ka investuar në blerjen e pasurive të paluajtshme në Shqipëri. Konkrektisht përmes kontratës së shitblerjes nr. 1267 rep dhe nr. 1016 kol, datë 09/09/2010, të lidhur ndërmjet subjektit " [REDACTED] sh.p.k" dhe shtetasit [REDACTED] ky i fundit ka blerë një njësi shërbimi me sipërfaqe 50.5 m<sup>2</sup>, që ndodhet në ZK 8603, me nr. 26/172-N8, vol 37, faqe 124, që ndodhet në lagjen "Lef Sallata", Vlorë, kundrejt çmimit prej 5.252.000 lekë, shumë e cila është likujduar jashtë zyrës notieriale.

Përmes kontratës së shitblerjes nr. 1526 rep dhe nr. 1039 kol, datë 22/07/2010, shtetasi [REDACTED] ka blerë pasurinë që ndodhet në ZK 3140, me numër 159/217 vol 10, faqe 73, e llojit pemishte me sipërfaqe 600 m<sup>2</sup> në shumën prej 4.200.000 Lekë, shumë e cila është likujduar jashtë zyrës notieriale.

Përmes kontratës së premtim shitje nr. 1364 rep dhe nr. 1200 kol, datë 11/09/2010, shtetasi [REDACTED], ka blerë apartamentin nr. 8, i përbërë nga 1+1, në katin e pestë nga toka në shumën prej 25.000 Euro, shumë e cila është likujduar dhe apartamenti i është dorëzuar më datë 11/09/2010. Nga hetimi rezulton se kjo kontratë nuk është regjistruar në regjistrat publik pranë DVASH Kadastrës Vlorë. Ndërsa nga përbajtja e kontratës rezulton se apartamenti nr. 8, i përbërë nga 1+1, në katin e pestë nga toka, ndodhet në objektin e ndërtuar në Orikum, sipas lejes së ndërtimit nr. 7/3, datë 08/12/2008 të KRRT-së pranë Bashksie Orikum, objekt i cili është ndërtuar nga subjekti " [REDACTED] sh.p.k".

Përmes kontratës së prenotim apartamenti nr. 1762 rep dhe nr. 1245 Kol, datë 21/10/2009, shtetasi [REDACTED] ka prenotuar një apartament banimi të tipit 36, me sipërfaqe 120.2 m<sup>2</sup>, me dy dhom gjumi, dy banjo, korridor dhe dy ballkone, kundrejt vlerës prej 84.140 Euro. Rezulton se shtetasi [REDACTED] ka likujduar shumën prej 42.000 Euro. Fakti i pagesës së kësaj shume provohet edhe nga deklarimet e shtetasit [REDACTED]. Nga hetimi rezulton se kjo kontratë nuk është regjistruar në regjistrat publik pranë DVASH Kadastrës Vlorë. Ndërsa nga përbajtja e kontratës rezulton se apartamenti ndodhet në katin e tetë nga toka, në objektin " [REDACTED]" të

ndërtuar në lagjen "Pavarësia", Vlorë, sipas lejes së ndërtimit nr. 4/52, datë 15/09/2006 të KRRT-së pranë Bashkisë Vlorë, objekt i cili është ndërtuar nga subjekti [REDACTED] sh.p.k dhe [REDACTED] sh.p.k.

Nga të dhënrat e administruarar pranë Bankës Kombëtare Tregtare, rezulton se shtetasit [REDACTED] disponojnë llogarinë nr. 408029669TIMDEPALLAV, me gjendje llogarie në shumën 709,251.27 Lekë. Ndërsa shtetasit [REDACTED] disponojnë pranë BKT-së llogarinë me numër 408141852TIMDEPEURAQ, me gjendje llogarie në shumën 20,059.55 Euro.

Ndërsa nga të dhënrat e administruara pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Vlorë, rezulton se shtetasit [REDACTED] ka regjistruar automjetin me targa [REDACTED] i cili është blerë në shumën prej 3.000 Euro. Gjithashtu, rezulton se shtetasit [REDACTED] ka regjistruar edhe automjetin me targa [REDACTED], të blerë në shumën prej 130.000 Lekë.

Në funksion të hetimit është vendosur kryerja e ekspertimit kontabël në lidhje me të ardhurat e shtetasit [REDACTED] dhe familjarëve të tij. Bazuar në aktin e ekspertimit kontabël rezulton se shtetasit [REDACTED] ka vepruar në llogari bankare në depozita të ndryshme ndër vite, në llogari dyemërore më shtetasin [REDACTED]. Depozitimet e shtetasit [REDACTED] datojnë që nga vitit 2003-2004 në llogarinë në lekë në shuma deri në 1.200.000 lekë dhe në vitin 2004 në monedhën Euro në bankën BKT, depozitime që arrijonë shumën 8.240 Euro. Në Bankën Societe General Albania ka depozituar shumën prej 6.000 Euro në vitin 2005. Në po këtë llogari, në vitin 2008 ai ka përfituar një transfertë prej 8.000 euro nga [REDACTED] ose [REDACTED]. Më datën 06/03/2008 ai ka tërhequr shumën e depozituar dhe shumën e transferuar e cila është gjithëscj 14.000 Euro. Në vitin 2012, shtetasit [REDACTED] ka depozituar 20.000 Euro cash në bankën BKT, në të njëjtën datë që janë tërhequr cash nga banka ProCredit, llogari dyemërore e [REDACTED]. Origjina e kësaj shume është depozitim cash nga [REDACTED] më datë 16/09/2009 në bankën ProCredit me përshkrimit "Derdhje nga [REDACTED]" "Të ardhura nga emigracioni". Rezulton se shtetasit [REDACTED] dhe [REDACTED] kanë qarkulluar mjete monetare në llogaritë dyemërore me prindërit [REDACTED] dhe [REDACTED]. Të gjitha shumat e qarkulluara i kanë ridepozituar në llogaritë bankare. Shuma e fundit e tërhequr dhe e rifutur në depozitë është shuma prej 20.000 Euro, më datë 21/09/2012, e cila është tërhequr fillimisht nga llogaria e [REDACTED] dhe [REDACTED]. Për tu depozituar tek llogaria e [REDACTED] dhe [REDACTED]. Rezulton se deri në muajin qershor të vitit 2014, shtetasit [REDACTED] ose [REDACTED] disponon në llogari bankare shumën prej 2.700.000 Lekë, shtetasit [REDACTED] ose [REDACTED] disponon në llogari bankare shumën prej 20.000 Euro, shtetasit [REDACTED] ose [REDACTED] disponin në llogari bankare shumën prej 15.000 Euro, shtetasit [REDACTED] disponon në llogari bankare shumën prej 6 Euro, dhe shtetasit [REDACTED] disponon në llogari bankare shumën prej 10.000 Euro. Pra deri në fund të muajit qershor të vitit 2014, shtetasit e mësipërm disponon në total në llogari bankare shumën prej 10.408.541 Lekë. Pasi janë marrë në konsideratë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe të ardhurat e shtetasve të mësipërm, eksperti ka konkluduar se shuma e pasurisë prei 24.698.509 lekë është pasuri e pajustifikuar dhe nga burime të paidentifikuara, ku në këtë

pasuri nuk është përfshirë banesa në proces legalizimi si dhe pasuria e blerë në ankand  
në vitit 1995.

Sipas prokurorisë, nga të dhënrat e mësipërme rezulton se pasuria e paluajtshme e përfituar nga shtetasit [REDAKTUE] ka si origjinë të ardhurat e përfituar nga shtetasit [REDAKTUE] nga aktiviteti kriminal i ushtruar prej tij në fushën e lëndëve narkotike në Itali. Rezulton e provuar se ky shtetas me vendim [REDAKTUE] përfundimtar nr. 3547/2012 të Gjykatës së Apelit të Firencës është dënuar me 4 vite e 8 muaj burg dhe me 18.000 Euro gjobë. Nga përmbajtja e vendimit rezulton se ky shtetas në bashkëpunim me një shtetas tjeter, ka poseduar në mënyrë të paligjshme lëndë narkotike, e konkretisht dy njësi që përmbanin 499,9 gr dhe 536 gr kokainë me princip aktiv në përqindje respektivisht 22.8% dhe 15.3%, që do të thotë të barabarta me 111.977 mg dhe 89.069 mg lëndë e pastër, që korrespondon me 760 dhe 547 doza të veçanta që kanë efekt drogues dhe 18 pako që përmbanin 1.7392 kg kokainë. Nëntet që kanë çuar në arrestimin e shtetasit [REDAKTUE] kanë nisur në muajin dhjetor të vitit 2010 dhe dyshohet se aktiviteti i paligjshëm është realizuar nga kjo periudhë e deri më datë 25/06/2011. Po ashtu, ky shtetas është hetuar edhe në kuadër të procedimit penal nr. 1030/2010 mod. 21 R.G.N.R. të Prokurorisë së Republikës pranë Gjykatës së Firencës. Për këto hetime, të lidhura me shkeljen e legjislacionit mbi lëndët narkotike, ky shtetas është arrestuar më datë 25/03/2014 në Arezzo, në zbatim të urdhërit përmes e sigurisë arrest në burg të dhënë më datë 07/03/2014, nga Gjykatësi për Hetimet Paraprake i Gjykatës së Firencës. Më pas pozicioni i shtetasit [REDAKTUE] është veçuar dhe është regjistruar në procedimin penal nr. 7577/2017 mod. 21 R.G.N.R. të Prokurorisë së Firencës dhe rezulton ende në fazën e hetimeve paraprake. Arrestimi i shtetasit [REDAKTUE] më datën 25/03/2014, ka lidhje me të njëjtat hetime të cilat kanë çuar në arrestimin e tij në flagrancë më datë 25/06/2011. Aktiviteti i paligjshëm dyshohet se është kryer nga muaji Dhjetor i vitit 2010 e deri në datën e arrestimit të tij. Nga këto të dhëna ekzistojnë dyshime të arsyeshme se ndodhemi para konsumimit të elementeve të veprës penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarësë kriminale", parashikuar nga nen 287/1 i Kodit Penal.

Mbështetur në të dhënat e përfituar nga hetimi, Prokuroria parashtron se ekzistojnë jashtë kriteret për caktimin e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive, të parashikuar nga nen 274 i K.Pr.Penal. Prokuroria parashtron kërkesën për sekuestro bazuar në nenet 36 dhe 247/1 të K.P.P.

## II. Vlerësimi ligjor.

Për të konkluduar në lidhje me bazueshmërinë në prova dhe në ligj të kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, Gjykata i referohet dispozitive ligjore që rregulojnë institutin e "sekuestros preventive" si një nga llojet e masave të sigurimit pasuror që mund të disponohen në funksion të procedimit penal. Konkretisht në nenin 274 të K.P.P. parashikohet se:

- "1. Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndoje ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetur.  
2. Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe qdo lloj pasurie tjeter që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal."

Në nenin 36 të Kodit Penal në të cilin referon neni 274/2 i K.P.P. parashikohet se:

- "1. Konfiskimi jepet nga gjykata dhe ka të bëjë me marrjen dhe kalimin në favor të shtetit:  
a) Të sendeve që kanë shërbyer ose janë caktuar si njët për kryerjen e veprës penale;  
b) Të produktive të veprës penale, ku përfshihet edo lloj pasurie si dhe dokumentat ose instrumentat ligjor që vërtetojnë tituj ose interesa të tjerë në pasurinë që rrjedh ose fitohet drejtëpërdrejtë ose fërthorazi nga kryerja e veprës penale....
4. Konfiskimi i nënshtrohet, edhe të ardhurat ose përfitimet e tjera nga produktet e veprës penale, nga pasuritë në të cilat janë transformuar ose shndëruar produktet e veprës penale ose nga pasuritë me të cilat janë përzier këto produkte, në të njëjtën masë dhe mënyrë sikurse produktet e veprës penale."

Nga sa më sipër identifikohen si kushte dhe kritere për lejimin e vendosjes së masës së sigurimit pasuror "sekuestro preventive" këto elementë:

Së pari, bazuar në të dhënrat e përfshira nga veprimet hetimore si më sipër cituar, rezulton se shtetasi [REDAKTUE] është person i dënuar nga Gjykata e Fiercës Itali dhe Gjykata e Rrethit Gjiqësor Vlorë, ose person nën procedim penal nga këto forume gjyqësore. Më konkretisht:

- Shtetasi [REDAKTUE] është dënuar me vendimin përfundimtar nr. 3547/2012 Gjykata e Apelit të Fiercës me 4 vite e 8 muaj burg dhe me 18.000 Euro gjobë, për shkelje të legjislacionit mbi lëndët narkotike. Shtetasi për këtë procedim është arrestuar më datë 25/06/2011.
- Shtetasi [REDAKTUE] është aktualisht nën hetim në kuadër të procedimit penal nr. 7577/2017 mod. 21 R.G.N.R i Prokurorisë së Fiercës. Arrestimi i shtetasit [REDAKTUE] më datën 25/03/2014, ka lidhje me të njëjtat hetime të cilat kanë çuar në arrestimin e tij në flagrancë më datë 25/06/2011. Aktiviteti i paligjshëm dyshohet se është kryer nga muaji Dhjetor i vitit 2010 e deri në datën e arrestimit të tij.
- Me vendimin nr.191, datë 12/04/2016, të Gjykatës së Rrethit Gjiqësor Vlorë është deklaruar faktor i pandehuri [REDAKTUE] për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe është dënuar me 5 (pesë) vite burgim, duke aplikuar nenin 59 të Kodit Penal.

Ndodhemi para rastit kur përfshirja e shtetasit në veprimtaritë kriminale si më sipër cituar, nuk është në nivelin e një dyshimi të arsyeshëm, por është fakt i konkluduar me dy vendime gjyqësore penale të formës së prerë. Rezulton gjithashtu se procedimet penale që vazhdojnë aktualisht ndaj [REDAKTUE] dhe vëllait të tij [REDAKTUE] i lidhen

po me aktivitetin e paligjshën në fushën e narkotikëve dhe kanë një shtrirje kohore që nga muaji Dhjetor 2010 dhe deri në datën e arrestimit të tyre.

Së dyti, nen 274 i K.P.P. kategorizon sendin mbi të cilin mund të aplikohet masa e sigurimit pasuror sekuestro preventive si send-produkt të veprës penale (duke referuar në nenin 36 të Kodit Penal) ose si send që lidhet me veprën penale, nga disponimi i lirë i të cilit mund të shtohen/rëndohen pasojat e veprës penale, mund të zgjaten në kohë pasojat e saj ose të lehtësitet kryerja e veprave të tjera penale. Rezulton se ky kategorizim i sendeve, të cilat i nënshtron potencialisht sipas ligjit masës së sigurimit pasuror "sekuestro preventive", duke garantuar edhe vazhdimësinë normale të procedimit penal, nxjerr në pah edhe kriteret apo kushtet për ligjshmérinë e vendosjes së kësaj mase sigurimi.

Në rastin objekt gjykimi, nga të dhënat hetimore të deritanishme, rezulton se pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme si më sipër identifikuar, përbëjnë produkte të veprave penale të "Prodhim dhe shitja e narkotikëve", vepër penale që gjen parashikim në legjislacionin penal shqiptar dhe atë italian, legjislacione mbi bazën e të cilave është dënuar më parë shtetasit [REDACTED] apo janë duke u hetuar aktualisht si [REDACTED] ashtu edhe vëllai i tij [REDACTED]

Gjithashtu nga të dhënat e përfshura nga veprimet hetimore ekzistojnë dyshime të arsyeshme se ndodhemi para konsumimit të elementeve të veprës penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", parashikuar nga nen 287 i Kodit Penal, rezultat përfshirur në bazë të:

- grumbllimit të të dhënavë në lidhje me veprimet juridike të blerjes së pasurive të paluajtshme, toke, apartament apo njësi shërbimi të kryera nga Luan Beshaj, babai i shtetasit [REDACTED] në lidhje me rregjistrimin e tyre ne rregjistrat e pasurive të paluajtshme, apo me blerjen e pasurisë të luajtshme të rregjistroshme si automjete në emër të [REDACTED] si dhe në lidhje me llogaritë bankare të këtyre të fundit në Republikën e Shqipërisë,
- si dhe nga krahasimi përmes analizës kontabël nga ekspertë të fushës (akt ekspertimi i administruar në fazën e hetimeve nga prokuroria) të nivelit të ardhurave nga burime të ligjshme, të deklaruara në raport me vlerën e pasurive/aseteve të sipërcituara, të evidentuara të blera dhe në pronesi të shtetasve [REDACTED] në periudhën kohore në të cilën është zhvilluar aktiviteti kriminal në fushën e narkotikeve, aktivitet ky i vërtetuar gjyqësisht me vendime gjyqësore të formës së prerë dhe episode të tjera të tij ende nën hetim edhe aktualisht nga Prokuroria e Firences, Itali.

Së terti. Në kushtet kur vërtetohet se pasuritë e sipërcituara përbëjnë pasuri të pajustifikuara dhe nga burime te paidentifikuara të ligjshme apo të deklaruara, ekziston dyshimi i arsyeshëm se pasuritë e sipërcituara kanë pikërisht si originë të krijimit të tyre, brenda një periudhe të shkurter kohore, aktivitetin e paligjshëm të kryer nga shtetasit [REDACTED] dhe [REDACTED]. Për pasojë ekziston dyshimi i arsyeshëm i mbështetur në prova se sendet identifikuar në këtë kërkësë përbëjnë produkte të veprës penale apo përbëjnë sende të lidhura me veprat penale për të cilat është dënuar shtetasi [REDACTED] apo janë nën hetim ai Vërtë dhe vëllai i tij [REDACTED]. Vlerësohet e

domosodshme për sa më sipër të procedohet me sekuestrimin e këtyre pasurive të paluajtshme dhe luajtshme për të ndaluar ardhjen e pasojave të mëtejshme më të rënda apo zgjatjen në kohë të pasojëve të veprës penale të "Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, e cila paraqet një natyre të qëndrueshme, duke synuar të shtrijë efektet e saj në kohë dhe në subjekte.

Ekziston mundësia se lënia në një rregjim të lirë të këtyre pasurive mund të shtojë më tej pasojat e veprimtarisë kriminale për të cilat shtetasi Dorina Beshaj është dënuar apo është duke u hetuar, ashtu sikurse mund të pasjellin cënimin e të drejtave dhe interesave të personave të tretë në mirëbesim që mund të përfshihen në transaksione për tjetërsimin e tyre apo pjesëve të tyre. Ekziston mundësia që mbi pasuritë të mund të kryhen veprime tjetërsimi me qëllim fshehjen e origjinës së paligjshme së tyre, në kushtet kur aktiviteti kriminal është nën hetim apo është evidnetuar në vendime gjyqësor të formës së prerë.

Sekuestrimi i shërbën ndër të tjera parandalimit të konsumimit të veprave të tjera penale, sikurse është ajo e "Mashtimit", parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal në dëm të të tretëve në mirëbesim. Konkludohet se plotësohen kushtet që parashikon neni 274/1 i K.P.P.

Për sa më sipër Gjykata vlerëson se kërkesa e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë është e bazuar në prova dhe në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

#### PËR KËTO ARSYE:

*Gjykata bazuar në nenet 274 të Kodit të Procedurës Penale, nenit 36 të Kodit Penal,*

#### VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Caktimin e masës së sigurimit pasuror sekuestro preventive të parashikuar nga neni 274 të K.Pr.Penale, mbi pasuritë e mëposhtme:
  - a) Pasurisë së paluajtshme e llojit njësi shërbimi me sipërfaqe 50.5 m<sup>2</sup>, që ndodhet në ZK 8603, Vlorë, me nr. 26/177-N8, vol 37, faqe 124, e cila ndodhet në lagjen "Lef Sallata", Vlorë, e blerë nga shtetasi [REDACTED] përmes kontratës së shitbljes nr. 1267 rep dhe nr. 1016 kol, datë 09/09/2010, kundrejt çmimit prej 5.252.000 Lekë.
  - b) Pasurisë së paluajtshme që ndodhet në ZK 3140, Vlorë, me numër 159/217 vol 10, faqe 73, e llojit pemishte, me sipërfaqe 600 m<sup>2</sup>, e blerë nga shtetasi [REDACTED] përmes kontratës nr. 1526 rep dhe nr. 1039 kol, datë 22/07/2010, në shumën prej 4.200.000 Lekë.
  - c) Pasurisë së paluajtshme e llojit apartament nr. 8, i përbërë nga 1+1, në katin e pestë nga toka, që ndodhet në objektin e ndërtuar në Orikum, sipas lejes së ndërtimit nr. 7/3, datë 08/12/2008 të KRRT-së pranë Bashkisë Orikum, objekt i cili është ndërtuar nga subjekti [REDACTED] sh.p.k, i cili është blerë përmes kontratës së premtim shitje nr. 1364 rep dhe nr. 1200 kol, datë 11/09/2010, nga shtetasi [REDACTED] në shumë prej 25.000 Euro.
  - d) Pasurisë së paluajtshme e llojit apartament banimi të tipit 36, me sipërfaqe 120.2 m<sup>2</sup>, me dy dhoma gjumi, dy banjo, korridor dhe dy ballkone, i cili

ndodhet në katin e tetë nga loka, në objektin "██████████" të ndërtuar në lagjen "Pavarësia", Vlorë, sipas lejes së ndërtimit nr. 4/52, datë 15/09/2006 të KRRT-së pranë Bashkisë Vlorë, objekt i cili është ndërtuar nga subjektet ██████████ sh.p.k dhe ██████████ sh.p.k dhe i prenotuar nga shtetas██████████, përmes kontratës nr. 1762 rep dhe nr. 1243 kol, datë 21/10/2009, për të cilin është paguar shumën prej 42.000 Euro.

- e) Të shumës prej 709,251.27 Lekë, të depozituara në Bankën Kombëtare Tregtare, në llogarinë nr. 408029669TIMDEPALLAV, në emër të shtetasve ██████████
- f) Të shumës prej 20,059.55 Euro, të depozituara në Bankën Kombëtare Tregtare në llogarinë me numër 408141852TIMDEPEURAQ, në emër të shtetasve ██████████
- g) Të automjetit targa ██████████ i regjistruar në emër të shtetasit ██████████ i cili është blerë në shumën prej 3.000 Euro.
- h) Të automjetit me targa ██████████ i regjistruar në emër të shtetasit ██████████ i cili është blerë në shumën prej 130.000 Lekë.

3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë brenda 5 ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e marrjes dijeni për sekuestron e vënë.

U shpall më datë 02.12.2019

GJYQTARE

ELONA MIHALI



Vendimi mori forme te prere me vendimin Nr 372, date 27.12.2019 te Gjykates se Apelit Vlore e cila ka vendlisur:

- Mospranimin e ankimit te ushtruuar prej personave te interesuar [REDACTED]  
[REDACTED] kundër vendimit Nr. 2209, date 02.12.2019 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore.

Vlore me 21.02.2020

KRYESEKRETARE  
Esmeralda NGUCAJ

